

VENDIM
Nr. 51, datë 3.7.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR TRAJTIMIN
JASHTËGJYQËSOR NGA BANKAT, TË KREDIMARRËSVE NË
VËSHITRËSI FINANCIARE”**

(ndryshuar me vendimin nr. 34, datë 28.5.2020)¹

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të neneve 57, pika 2, 58, pika 1, shkronja “c”, 61, 66/1 dhe të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredimarrësve në vështirësi financiare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet deri në datën 31.12.2020.

KRYETAR
Gent Sejko

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës së bashkëpunimit ndërmjet bankave, me qëllim krijimin e kushteve për trajtimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve të përbashkët, që janë në vështirësi financiare.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i rregullores është reduktimi i kredive me probleme dhe mbajtja nën kontroll e cilësisë së portofolit të kredisë, duke nxitur trajtimin e kredimarrësve në vështirësi financiare, nëpërmjet një bashkëpunimi të strukturuar dhe eficient ndërmjet bankave.

Në kushtet kur portofoli i kredisë përfaqëson aktivitetin kryesor të bankave dhe kreditë me probleme ndikojnë negativisht qëndrueshmërinë e tyre, ato përbëjnë potencial në krijimin e rrezikut sistematik, me pasojë që cenon stabilitetin financiar dhe rritjen ekonomike të vendit.

¹ Me vendimin nr. 34, datë 28.5.2020 Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi:
“1. Të miratojë shtyrjen e efekteve të rregullores nr. 51, datë 3.7.2019, “Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredimarrësve në vështirësi financiare”, deri në datën 1.1.2022.”

Neni 3 **Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) neneve 57, pika 2, 58, shkronja “c”, 61, 66/1 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet “ligji për bankat”.

Neni 4 **Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5 **Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren nr. 62, datë 14.9.2011 “Për administrimin e rrezikut të kredisë në bankat dhe degët e bankave të huaja”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “kredimarrës në vështirësi financiare” - është kredimarrësi individual ose grupi i kredimarrësve të lidhur, që plotëson njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

- është i ekspozuar në më shumë se një bankë dhe ekspozimi total i tij në të gjitha bankat është më i madh se 250 milionë lekë;

- detyrimi i tij në një ose më shumë banka, ka qenë në vonesë të paktën 90 ditë, ose kur ndonjëra prej këtyre bankave kreditore vlerëson se kredimarrësi është ose mund të jetë në vështirësi financiare dhe për këtë i nevojitet një zgjidhje;

- veprimtaria e tij mund të vijojë, pavarësisht përkeqësimit të gjendjes financiare, dhe për këtë nevojitet marrja e masave për riaftësimin e tij në shlyerjen e detyrimeve, në rast se përfitimet nga ky proces janë më të mëdha sesa nga procesi i likuidimit sipas legjislacionit për falimentimin;

b) “moratorium i veprimeve” - është periudha deri në 90 ditë, që nga nënshkrimi i marrëveshjes midis bankave dhe kredimarrësit në vështirësi financiare (aneksi 2), dhe gjatë së cilës bankat nuk kryejnë veprimet e mëposhtme:

- i) nuk ushtrojnë asnjë presion të njëanshëm ndaj debitorit për shlyerjen e detyrimeve;
- ii) nuk bëjnë asnjë përpjekje për të përmirësuar pozicionin ndaj bankave të tjera kreditore;

- iii) nuk marrin garanci (kolateral) shtesë nga pasuritë e debitorit;

- iv) nuk vazhdojnë procedurat ligjore të nisura përpara nënshkrimit të marrëveshjes të përcaktuar në aneksin 2, përveç atyre që janë të nevojshme për të shmangur humbjen e të drejtave ligjore.

- v) nuk ndërmarrin veprime ose procese të reja e të njëanshme ligjore;

c) “bankë kreditore” - është secila prej bankave ndaj të cilave një debitor ka detyrime kredie, në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes midis bankave për trajtimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve në vështirësi financiare.

d) “kredimarrës të lidhur” - ka të njëjtin kuptim me termin “persona ose grup personash të lidhur” në nenin 4, pika 9.1, të ligjit për bankat.

KREU II TRAJTIMI JASHTËGJYQËSOR

Neni 6

Masat për trajtimin jashtëgjyqësor

1. Bankat, me qëllim reduktimin e kredive me probleme dhe ruajtjen e cilësisë së portofolit të kredisë, sigurojnë trajtimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve në vështirësi financiare, nëpërmjet zbatimit të disa masave, siç përcaktohen në pikën 2, të këtij neni.

2. Masat për trajtimin jashtëgjyqësor përfshijnë të paktën një ose disa prej mundësive të mëposhtme:

- a) zgjatjen e afatit të kredisë;
- b) dhënien e financimeve shtesë, nëse nevojitet rritja e kapitalit qarkullues dhe/ose financimi i investimeve të reja;
- c) likuidimin e aktiviteteve dytësore që nuk lidhen drejtpërdrejt me biznesin kryesor të kredimarrësit në vështirësi financiare;
- d) rritjen e kapitalit nëpërmjet financimit;
- e) kryerjen e ndryshimeve në strukturën dhe mënyrën e drejtimit të subjektit;
- f) shitje të pasurive të luajtshme ose të paluajtshme të kredimarrësit në vështirësi financiare;
- g) konvertim të borxhit në kapital;
- h) çfarëdo mase tjetër që favorizon vazhdimin e biznesit dhe forcon qëndrueshmërinë e tij, duke rritur në të njëjtën kohë mundësinë e rimëkëmbjes.

Neni 7

Marrëveshja e bashkëpunimit

1. Bankat nënshkruajnë një marrëveshje midis tyre, me qëllim përcaktimin e kushteve të përgjithshme të bashkëpunimit, për trajtimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve në vështirësi financiare, siç përcaktohet në aneksin 1, të kësaj rregulloreje.

2. Kjo marrëveshje konsideron parimet kryesore për ristrukturimin e kredive, kryesisht parimet 3 dhe 4, të udhëzuesit të Bankës së Shqipërisë “Për Ristrukturimin e Kredive të Biznesit”.

3. Banka e Shqipërisë asiston në nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis bankave, si dhe monitoron në vazhdimësi ecurinë e këtij procesi.

Neni 8

Parime të organizimit dhe të vendimmarrjes së përbashkët

1. Bankat, për realizimin e procesit të trajtimit jashtëgjyqësor të kredimarrësit në vështirësi financiare, përveç sa përcaktohet në marrëveshjen midis tyre, sigurojnë:

- a) krijimin e strukturave të përbashkëta, me qëllim shkëmbimin dhe analizën e informacionit, si dhe miratimin e masave më të përshtatshme për trajtimin e kredimarrësve në vështirësi financiare, në varësi të kompleksitetit të marrëdhënies me ta;

b) përfaqësimin nga administratorët, të cilët kanë autoritetin e nevojshëm nga strukturat drejtuese të tyre (bankave), për të negociuar dhe arritur dakordësinë për trajtimin e përbashkët;

c) diskutimin dhe dakordësinë, duke respektuar parimin e proporcionalitetit lidhur me nivelin e ekspozimeve, me qëllim ruajtjen e pozitës së secilës prej tyre dhe duke vlerësuar në mënyrë të balancuar bankat me pozicion më të favorshëm;

d) ruajtjen e konfidencialitetit përgjatë gjithë procesit të trajtimit jashtëgjyqësor të kredimarrësit në vështirësi financiare, me qëllim mbrojtjen e biznesit të debitorit dhe për të nxitur zgjidhjen.

2. Bankat diskutojnë për mundësitë, të cilat i ofrohen apo edhe ofron kredimarrësi në vështirësi financiare për të vijuar veprimtarinë e tij të biznesit, pa iu shmangur detyrimeve të këtij të fundit ndaj tyre.

3. Bankat zbatojnë masat e trajtimit jashtëgjyqësor në rastet kur vlerësohet dhe gjykohet se në të ardhmen gjendja financiare e kredimarrësit në vështirësi financiare do të përmirësohet ndjeshëm dhe se kredimarrësi do ta shlyejë kredinë.

4. Bankat njoftojnë Bankën e Shqipërisë për sa më sipër, e cila mund të marrë pjesë si vëzhguese në takimet që do të bëhen midis tyre, si dhe e njoftojnë në vazhdimësi për ecurinë e procesit.

Neni 9

Këshilltarët e jashtëm

1. Në procesin e trajtimit jashtëgjyqësor të kredimarrësve në vështirësi financiare, mund të përfshihen edhe palë të treta, në rolin e këshilltarëve të jashtëm, për kryerjen e analizave financiare, ofrimin e zgjidhjeve të përshtatshme, bazuar në eksperiencën e këtyre të fundit, si dhe për çështje juridike.

2. Zgjedhja e këshilltarëve të jashtëm nuk duhet të kufizohet nga kostot e procesit.

3. Marrëdhëniet me këshilltarët e jashtëm rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve paraprake, duke përcaktuar në këto marrëveshje edhe çështjen e konfidencialitetit të informacionit dhe konfliktet e interesave.

Neni 10

Marrëveshja me kredimarrësin në vështirësi financiare

1. Bankat të cilat vendosin të bashkëpunojnë me kredimarrësin në vështirësi financiare me qëllim trajtimin jashtëgjyqësor të kredimarrësit, nënshkruajnë marrëveshjen tip të përcaktuar në aneksin 2 të kësaj rregulloreje.

2. Bankat mund të përshtatin marrëveshjen sipas nevojave të rastit konkret, pa cenuar detyrimin për moratoriumin e veprimeve.

Neni 11

Kufizimet

1. Banka e Shqipërisë zbaton kufizimet e përcaktuara në pikën 3, të këtij neni respektivisht për bankat të cilat nuk nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit të përcaktuar në aneksin 1 ose që janë shkaktare për mosrealizimin e marrëveshjeve të përcaktuara në anekset 1 dhe 2, të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë do të konsiderojë si shkak për mosrealizimin nga ana e bankave të marrëveshjeve të përcaktuara në anekset e kësaj rregulloreje, të paktën një ose disa prej veprimeve të mëposhtme:

a) nuk shkëmben apo shpërndan informacion për kredimarrësin në vështirësi financiare, për të cilin është në dijeni me bankat e tjera;

b) refuzon të marrë pjesë në diskutime ose në bashkëpunimin me bankat e tjera, pa ndonjë arsye të qëndrueshme;

c) ndërmerr veprime të njëanshme për ekspozimin ndaj kredimarrësit në vështirësi financiare, gjatë periudhës së moratoriumit;

d) arsye të tjera që pengojnë procesin e trajtimit të përbashkët të kredimarrësve në vështirësi financiare;

3. Banka e Shqipërisë, në kuadrin e procesit të rishikimit dhe vlerësimit mbikëqyrës për mjaftueshmërinë e kapitalit, sipas udhëzimit nr. 26, datë 3.5.2017 “Për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit”, zbaton një ose disa nga kufizimet mbikëqyrëse sipas kreut VI, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” për rastet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Bankat kreditore, në rastet kur debitori nuk bie dakord me marrëveshjen e propozuar për ristrukturim, bien dakord që të bëjnë një riklasifikim të menjëhershëm të debitorit, por në asnjë rast më lart se kategoria “nënstandard”.

Neni 12

Dispozita të tjera

Bankat sigurojnë zbatueshmërinë e kërkesave të akteve të tjera rregullative gjatë kohës që kjo rregullore shtrin efektet e saj.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Gent Sejko

ANEKSI 1

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MIDIS BANKAVE PËR TRAJTIMIN E KREDIMARRËSVE NË VËSHTIRËSI FINANCIARE

Duke mbajtur në konsideratë se:

- rritja e kapacitetit të bankave për të kredituar ekonominë lidhet ngushtë me aftësinë e tyre për të rikuperuar në kohë kreditë e dhëna;

- bankat do të përfitonin nga shlyerja e kredive dhe ulja e treguesit të kredive me probleme;

- përfitimet nga trajtimi jashtëgjyqësor i kredimarrësve në vështirësi financiare mund të jenë më të mëdha sesa nga likuidimet e panevojshme të biznesit, me kontribut në drejtim të ruajtjes së marrëdhënieve afatgjata të bankës me klientët debitorë;

- kreditë me probleme ndikojnë negativisht në një masë të konsiderueshme në gjendjen financiare të bankës,

U ra dakord si më poshtë:

I. PALËT E MARRËVESHJES

(EMRAT E BANKAVE)

Në vijim të referuara si Bankat, janë palë në këtë marrëveshje. Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nënkuptohet që Bankat kanë njoftuar bankat e tyre mëmë, aty ku është e zbatueshme, për këtë angazhim të tyre.

II. OBJEKTI I MARRËVESHJES

Objekt i kësaj marrëveshjeje është trajtimi i kredimarrësve në vështirësi financiare, duke i mundësuar këtyre të fundit shlyerjen e kredive ndaj bankave. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, palët kërkojnë të përmbushin shlyerjen e detyrimeve nga kredimarrësit

brenda një periudhe kohore të arsyeshme, nëpërmjet rishikimit të marrëdhënieve të tyre me këta të fundit, ndërsa sigurojnë vijimësinë e qëndrueshme të biznesit të tyre, duke ruajtur kontributin pozitiv në ekonomi.

III. NIVELI I ZBATIMIT TË MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje zbatohet për kredimarrësin e bankave (kredimarrës individual ose grup i lidhur kredimarrësish) në vështirësi financiare, sipas përkufizimit më poshtë, këtu e në vijim të cilësuar Debitor, e që plotëson njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

- i ekspozuar në më shumë se një bankë – këtej e në vijim bankë kreditore;
- ekspozimi total i tij (debitorit) në të gjitha bankat kreditore është më i madh se 250 milionë lekë;
- detyrimi i të cilit në një ose më shumë banka kreditore, ka qenë në vonesë të paktën 90 ditë, ose kur ndonjëra prej bankave kreditore vlerëson se kredimarrësi po përballet me vështirësi financiare dhe për këtë nevojitet një zgjidhje;
- veprimtaria e tij mund të vijoje, pavarësisht problematikave, dhe për këtë nevojitet marrja e masave për riaftësimin e tij në shlyerjen e detyrimeve kur vlerësohet se përfitimet nga ky proces janë më të mëdha sesa nga procesi i likuidimit sipas legjislacionit për falimentimin.

IV. DETYRIMET E PALËVE NË MARRËVESHJE

a) Komunikimi midis bankave

Kur një Bankë kreditore vlerëson se janë përmbushur kriteret e përcaktuara në **Seksionin III** më sipër, informon bankat me të cilat ka ekspozim debitori dhe që janë pjesë e kësaj marrëveshjeje. Brenda 10 ditësh pune, bankat kreditore të ekspozuara ndaj debitorit caktojnë njërën prej bankave si Bankë Udhëheqëse, e cila në parim është banka me ekspozimin më të madh, por mund të jetë edhe një bankë tjetër nëse bankat vendosin ndryshe. Banka Udhëheqëse do të drejtojë procesin e negociatave për hartimin e planit të zgjidhjes, plan i cili përmban të paktën një ose disa nga masat e përcaktuara në nenin 6 të rregullores “Për trajtimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve në vështirësi financiare të bankave”.

Banka e Shqipërisë mbahet në dijeni në të gjitha komunikimet e parashikuara në këtë seksion. Banka e Shqipërisë, në bazë të informacionit që disponon, informon bankat kreditore për ndonjë ekspozim të mundshëm të debitorit që rezulton të jetë jashtë dijenisë së këtyre të fundit.

b) Komunikimi me debitorin

Brenda 5 ditëve pune nga caktimi i saj si Banka Udhëheqëse, kjo e fundit, me autorizimin apo me praninë e bankave kreditore, kontakton debitorin në mënyrë që t'i shfaqë shqetësimin lidhur me situatën dhe të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të detyrimeve në vonesë.

c) Negocimi i trajtimit jashtëgjyqësor

Në ato raste kur nuk kryhet shlyerja e menjëhershme e kredisë dhe debitori bie dakord për fillimin e diskutimeve për një trajtim jashtëgjyqësor, bankat kreditore administrojnë së bashku procesin nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes Debitor-Kreditor. Bankat kreditore do të njoftojnë Bankën e Shqipërisë brenda 5 ditëve pune për çdo Marrëveshje Debitor-Kreditor të nënshkruar.

Sipas situatës specifike të debitorit, trajtimi jashtëgjyqësor i tij mund të përfshijë:

- i) zgjatjen e afatit të kredisë;
- ii) dhënien e financimeve shtesë nëse nevojitet, rritjen e kapitalit qarkullues dhe/ose financimin e investimeve të reja;
- iii) likuidimin e aktiviteteve dytësore që nuk lidhen drejtpërdrejt me biznesin kryesor të debitorit;
- iv) rritjen e kapitalit nëpërmjet financimit;
- v) kryerjen e ndryshimeve në strukturën apo mënyrën e drejtimit;

vi) shitje të pasurive të luajtshme ose të paluajtshme të debitorit;
vii) konvertim të borxhit në kapital;
viii) çfarëdo mase tjetër që favorizon vazhdimin e biznesit të debitorit dhe forcon qëndrueshmërinë e tij, duke rritur në të njëjtën kohë mundësitë e rimëkëmbjes.

Çdo debitor do të trajtohet duke marrë parasysh situatën e tij specifike. Për këtë qëllim, do të identifikohen problemet me të cilat përballet debitori dhe shkaqet e tyre, duke kërkuar të dhënat e nevojshme nga debitori. Negociatat do të kryhen në mirëbesim, në mënyrë që të gjendet trajtimi më i përshtatshëm.

Trajtimi i debitorit në kuadër të kësaj marrëveshjeje do të kryhet në përputhje me të gjitha ligjet, rregulloret, procedurat dhe parimet në fuqi.

d) Moratoriumi i veprimeve

Gjatë periudhës deri në 90 ditë të moratoriumit, bankat kreditore angazhohen të mos kryejnë veprimet e mëposhtme:

- i) nuk ushtrojnë asnjë presion të njëanshëm ndaj debitorit për shlyerjen e detyrimeve;
- ii) nuk bëjnë asnjë përpjekje për të përmirësuar pozicionin ndaj bankave të tjera kreditore;
- iii) nuk marrin garanci (kolateral) shtesë nga pasuritë e debitorit;
- iv) nuk vazhdojnë procedurat ligjore të nisura përpara nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet bankave dhe kreditorit në vështirësi financiare e, përveç atyre që janë të nevojshme për të shmangur humbjen e të drejtave ligjore;
- v) nuk ndërmarrin veprime ose procese të reja e të njëanshme ligjore.

e) Konfidencialiteti

Të gjitha bankat kreditore që marrin pjesë në negociatat e ristrukturimit, do të ruajnë konfidencialitetin përgjatë procesit, me qëllim mbrojtjen e biznesit të debitorit dhe nxitjen e zgjidhjes.

f) Shumica

Banka Udhëheqëse, pasi ka negociuar me debitorin, propozon një marrëveshje, për të cilën çdo bankë voton individualisht. Marrëveshja miratohet me një shumicë që kërkon miratimin e bankave që mbajnë të paktën 65% të detyrimit total të debitorit dhe mbi 50% të numrit të bankave kreditore. Kur arrihet një marrëveshje e detyrueshme, bankat kreditore bien dakord që të nënshkruajnë planin për trajtimin jashtëgjyqësor të debitorit (plani i zgjidhjes).

V. AFATI I NEGOCIATAVE

Për shkak të rëndësisë së faktorit kohor për trajtimin e debitorëve, procesi i përshkruar në seksionin IV të kësaj marrëveshjeje do të ndërmerret dhe do të finalizohet në mënyrë të shpejtë. Në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme që duhet të vlerësohen bashkërisht nga bankat kreditore lidhur me debitorin, hartimin e planit të zgjidhjes duhet të finalizohet brenda 90 ditëve nga nënshkrimi i Marrëveshjes ndërmjet debitorit dhe bankave kreditore.

VI. TË DREJTAT E PALËVE NË RAST MOSREALIZIMI TË PLANIT TË ZGJIDHJES

Në rast se plani i zgjidhjes nuk arrin të finalizohet, të drejtat e Bankave Kreditore për kontratat individuale që kanë me debitorët mbeten të pacenuara.

Të gjitha bankat, brenda 10 ditëve pune nga nënshkrimi i saj, shkëmbejnë zyrtarisht kontaktet e punonjësve të ngarkuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

Si dëshmi të pranimit të të gjitha kushteve të kësaj marrëveshjeje, përfaqësuesit e bankave nënshkruajnë si më poshtë.

Data: / /

ANEKSI 2

MARRËVESHJA NDËRMJET DEBITORIT DHE BANKAVE KREDITORE

Kjo marrëveshje lidhet ndërmjet:

_____ sh.p.k /sh.a. (debitori), një shoqëri e themeluar në përputhje me ligjin [VENDOS LIGJIN PËRKATËS] me adresë në:

[VENDOS EMRIN E BANKËS UDHËHEQËSE].

Duke marrë në konsideratë se:

Shoqëria _____ plotëson kushtet për t'u konsideruar si një kredimarrës në vështirësi financiare, sipas përkufizimit të nenit 5, shkronja "a" të rregullores "Për trajtimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve në vështirësi financiare të bankave" (më poshtë referuar si "debitori").

Debitori ka bërë një kërkesë për përgatitjen e një plani masash për trajtimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve në vështirësi financiare (më poshtë referuar si "Plan Zgjidhjeje") në lidhje me bankat (përmenden të gjitha bankat).

Bankat kanë autorizuar Bankën _____ si Bankë Udhëheqëse, për t'i përfaqësuar në këtë marrëveshje (bashkangjitur janë autorizimet e secilës bankë).

Debitori njeh detyrimet ndaj bankave (listohen detyrimet ndaj secilës bankë), për një shumë totale prej _____.

Bankat shprehin vullnetin e tyre për të bashkëpunuar në realizimin e një plani zgjidhjeje, me qëllim _____.

Palët bien dakord për sa vijon:

1. Përkufizimet

1.1 Për qëllime të kësaj marrëveshjeje:

1.1.1 "Plani i zgjidhjes", është plani i cili përmban të paktën një ose disa nga masat e përcaktuara në nenin 6 të rregullores "Për trajtimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve në vështirësi financiare të bankave".

1.1.2 "Banka Kreditore" është secila prej bankave ndaj të cilave debitori ka kredi në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

1.1.3 "Periudha e Negocimit" nënkupton periudhën gjatë së cilës negociohet për hartimin e një plani zgjidhjeje, deri në miratimin e tij dhe që në çdo rast nuk është më e gjatë se 90 ditë.

1.1.4 "Banka Udhëheqëse" është Banka Kreditore, e cila është autorizuar nga bankat kreditore, të udhëheqë procesin e negocimit me debitorin gjatë periudhës së negocimit, si dhe të kontrollojë zbatimin e planit të zgjidhjes.

2. Plani i zgjidhjes

2.1 Debitori, në bashkëpunim me bankat kreditore, harton një plan zgjidhjeje të plotë, transparent dhe të realizueshëm, duke përfshirë një analizë të industrisë dhe një parashikim të arsyeshëm të rrjedhjes së parave (*cash-flow*), brenda tre javësh nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje.

2.2 Debitori bie dakord të vendosë në dispozicion të bankave ose personave të autorizuar prej tyre, në mënyrë të shpejtë dhe të pakushtëzuar, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga bankat për vlerësimin e situatës financiare dhe planit të mundshëm të masave. Debitori bie dakord që ky informacion dhe çdo e dhënë apo vlerësim tjetër i bankave shkëmbehet lirisht ndërmjet tyre.

2.3 Debitori, në bashkëpunim me Bankën Udhëheqëse, mund të emërojë një këshilltar, duke përfshirë këshilltarin financiar, teknik ose ligjor, për të përgatitur dhe zhvilluar një plan të zbatueshëm dhe ka përgjegjësinë të paguajë kostot dhe tarifat e këshilltarit. Kostot do të përballohen sipas mënyrës së rënë dakord midis palëve.

2.4 Debitori bie dakord të bashkëpunojë plotësisht me këshilltarin në fjalë dhe i siguron këtij të fundit, të gjitha informacionet e nevojshme në kohë dhe në mënyrë efikase.

3. Detyrimet e bankave kreditore (Moratoriumi i veprimeve)

Bankat kreditore bien dakord që deri në 90 ditë nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, të respektojnë kufizimet e mëposhtme:

- a) nuk ushtrojnë asnjë presion të njëanshëm ndaj debitorit për shlyerjen e detyrimeve;
- b) nuk bëjnë asnjë përpjekje për të përmirësuar pozicionin ndaj bankave të tjera kreditore;
- c) nuk marrin garanci (kolateral) shtesë nga pasuritë e debitorit;
- d) nuk vazhdojnë procedurat ligjore të nisura përpara nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, përveç atyre që janë të nevojshme për të shmangur humbjen e të drejtave ligjore.
- e) nuk ndërmarrin veprime ose procese të reja e të njëanshme ligjore.

4. Detyrimet e debitorit

4.1 Gjatë periudhës që plani i zgjidhjes është në shqyrtim, përgatitje ose zbatim, debitori bie dakord që, pa pëlqimin paraprak të Bankave Kreditore, të mos ndërmarrë asnjë nga veprimet e mëposhtme:

- a) të krijojë ose të marrë borxhe shtesë;
- b) të bëjë ndonjë investim, shpenzim ose të devijojë fondet, përveçse rrjedhës normale të veprimtarisë së tij;
- c) të bëjë transferimin e fondeve për qëllime të ndryshme nga biznesi i tij, madje edhe si individ;
- d) të transferojë, tjetërsojë ose disponojë pasuri (të luajtshme ose të paluajtshme) jashtë rrjedhës së zakonshme të biznesit të tij;
- e) të garantojë detyrimet e personave të tjerë fizikë ose juridikë;
- f) të ndikojë në ndryshime të rëndësishme të strukturës së tij të drejtimit ose në përbërjen e organeve drejtuese;
- g) të ndikojë në ndonjë ndryshim në strukturën e kapitalit, duke përfshirë përbërjen dhe pjesëmarrjen e aksionerëve;
- h) të jetë subjekt apo të fillojë ndonjë procedurë për likuidimin ose riorganizimin e aktivitetit;
- i) të vendosë hipotekë, barrë siguruese ose garanci (kolateral) shtesë mbi pasuritë e tij apo aktive të tjera (duke përfshirë balancat e llogarive bankare ose të arkëtueshme);
- j) të kryejë pagesa preferenciale, duke përfshirë çdo shlyerje borxhi ndaj kreditorëve;
- k) të hyjë në ndonjë transaksion të këmbimit valutor, swap, ose derivativë, përveçse në rrjedhën e zakonshme të biznesit të tij për të mbuluar ekspozimet ekzistuese tregtare;
- l) të angazhohet në çdo veprimtari, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përveç veprimtarive ekzistuese të biznesit;
- m) të bëjë pagesa për aksionerët, në formën e dividendëve, të shlyejë pjesë të kapitalit, të ripaguajë borxhet e varura apo të tjera pagesa të ngjashme;
- n) të ndryshojë ose të modifikojë statutin e shoqërisë;

o) të ndërmarrë ose të vazhdojë ndonjë veprim ligjor ose procedurë kundër Bankave Kreditore gjatë periudhës së negociimit.

4.2 Debitori do të zbatojë kufizimet, siç kërkohen nga bankat kreditore, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të masave të përcaktuara në planin e zgjidhjes.

4.3 Debitori bie dakord dhe merr përsipër të paguajë tarifat për përgatitjen dhe finalizimin e dokumenteve ligjore për bankat kreditore. Gjithashtu, debitori bie dakord dhe merr përsipër që të paguajë tarifa të ndryshme, si për shembull, tarifat e Bankës Udhëheqëse, tarifat për dokumentacionin etj., në varësi të planit të zgjidhjes së miratuar. Debitori do të paguajë edhe tarifat/komisionet e këshillimit. Nëse bihet dakord, tarifat e përshkruara më lart mund të ndahen ndërmjet debitorit dhe Bankave Kreditore.

4.4 Debitori njeh dhe pranon që nëse detyrimet e planit të zgjidhjes nuk përmbushen, bankat kreditore kanë të drejtë të zgjidhin këtë marrëveshje dhe marrëdhënia e debitorit me bankat kreditore do të vazhdojë të rregullohet sipas kontratave përkatëse.

5. Mbrojtja e veprimeve të ndërmarra në mirëbesim

5.1 Debitori pranon dhe merr përsipër të dëmshpërblejë dhe të mbajë të paprekura bankat kreditore për të gjitha humbjet, kostot, dëmet, detyrimet, pretendimet, veprimet, gjobat, tarifat, shpenzimet e tjera (duke përfshirë tarifat e avokatëve dhe shpenzimet gjyqësore), të cilat bankat mund të jenë të detyruara të paguajnë si rezultat i kësaj Marrëveshjeje Debitor-Kreditor, dhe/ose nga angazhimet dhe përfaqësimet e përcaktuara këtu, dhe/ose nga moszbatimi i planit të zgjidhjes nga ana e tij.

6. Detyrimi për njoftim

6.1 Banka Udhëheqëse ose secila nga bankat informon Bankën e Shqipërisë nëse një ose disa Banka Kreditore nuk zbatojnë detyrimet e kësaj Marrëveshjeje, duke dhënë edhe arsyet përkatëse, si dhe njofton edhe bankat kreditore për këtë informacion.

7. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

7.1 Nëse do të lindë ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet debitorit dhe bankave kreditore në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, një mosmarrëveshje e tillë do të zgjidhet në mënyrë miqësore.

7.2 Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet në mënyrë miqësore, të paktën njëra nga palët njofton palën tjetër formalisht 15 ditë përpara për zgjidhjen e kësaj marrëveshjeje. Pas përfundimit të afatit 15-ditor nga ky njoftim, kjo marrëveshje deklarohet e zgjidhur dhe marrëdhënia e debitorit me bankat kreditore do të vazhdojë të rregullohet sipas kontratave përkatëse.

8. Angazhimi i palëve

8.1 Palët e kësaj marrëveshjeje bien dakord të respektojnë kushtet e kësaj marrëveshjeje dhe kushtet që përcaktohen në planin e zgjidhjes.

Banka Udhëheqëse:

Përfaqësuar nga:

Debitori:

_____ sh.p.k. /sh.a.

Përfaqësuar nga:

_____ Administrator / Përfaqësuesi i debitorit

Data: / /

